

**Nr. 3.Prot.**

## **KONTRATË SHËRBIMI**

E lidhur sot, në datë 18.01.2019, ndërmjet palëve të mëposhtme:

1.Jetmira ZENELI, Kontabiliste e Miratuar,me Nr Lic 854/2015 dhe regjistruar ne QKB me NUIS L93708802N, që më poshtë do të quhet OFRUESE E SHËRBIMIT

### **DHE**

2. ANSI2016 shpk, i përfaqësuar në këtë kontratë nga Z.Arber HOXHA,Administator i firmes ,që më poshtë do të quhet POROSITËSI.

### **Neni 1**

#### **OBJEKTI I KONTRATËS**

1.1 Objekt i kësaj kontrate është:

Kryerja e monitorimit të shpenzimeve dhe te ardhurave te veprimtarise se firmes ne mënyrë ligjore, të paanshme, transparente dhe profesionale, ne baze te ligjit Nr.9228, datë 29.4.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar.

Konkretisht: mirëmbajtja e regjistrave kontabël, duke përfshirë raportet e menaxhimit dhe hartimin vjetor te pasqyrave financiare, rishikimi i regjistrave të kontabilitetit, mardheniet dhe veprimet me llogarite bankare sipas edhe prokures se leshuar nga Porositesi i sherbimit, konsulencë për menaxhimin e financave, shërbime të konsulences dhe mbrojtjes fiskale, pajtueshmëri tatimore, kontabilizime, mbledhje e informacionit, vleresimi i deklarimeve, ballafaqimi me kontrollet e administrates.

### **Neni 2**

#### **KOHËZGJATJA E KONTRATËS**

Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga të dy palët dhe është e vlefshme deri në plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë kontratë në ligj dhe aktet nënligjore.Per nje afat 3-vjet nga data e lidhjes.

**Neni 3**  
**Referenca Ligjore**

Dipozitat e kësaj kontratë i referohen Ligj Nr.9228, datë 29.4.2004 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare i ndryshuar, dhe Lgji Nr. 25/2018 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.

**Neni 4**  
**ÇMIMI I CAKTUAR**

- 4.1 Çmimi i shërbimit të kryer do të jetë 10,000 (dhjetemijë) Lekë në muaj me tvsh.  
4.2 Shuma totale e kësaj kontrate do të lëshohet me fature tatimore nga ofruesi i shërbimit një herë në vite, në fund të vitit.

**Neni 5**  
**MËNYRA E PAGESËS**

- 5.1 Pagesa do të kryhet në monedhë shqiptare (Lekë).  
5.2 Pagesa do të bëhet me banke. Porositësi është i detyruar të paguajë çmimin e caktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, brenda një afati prej 10 ditë nga data e marrjes në dorëzim të faturës tatimore të shitjes nga Ofruesi i Shërbimit.

**Neni 6**  
**TË DREJTAT DHE DETYRIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMIT**

- 6.1 OFRUESI I SHËRBIMIT merr përsipër kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në nenin 1 (një) të kësaj kontrate.  
6.2 OFRUESI I SHËRBIMIT është i detyruar të realizojë shërbimin me anë të vëzhgimit dhe ndjekjes hap pas hapi të veprimtarisë së firmes.  
6.3 OFRUESI I SHËRBIMIT duhet të hartojë raportin përfundimtar për pasqyrat financiare në përputhje me Ligjin nr.9228, dt. 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.  
6.5 OFRUESI I SHËRBIMIT duhet të paraqitet në zyrat e firmes Ansi2016 shpk, sa herë kjo e fundit ta thërras për sqarime të nevojshme, pas depozitimit të raportit përfundimtar.

**Neni 7**  
**TË DREJTAT DHE DETYRIMET E POROSITËSIT**

7.1 POROSITËSI është i detyruar të njoftojë menjëherë ofruesin e shërbimit për të dhënat e veprimatrise se tij, për çdo shtese ose ndryshim të dhenash.

**Neni 8**  
**SIPËRMARRJA**

OFRUESI I SHËRBIMIT për plotësimin e shërbimeve sipas kësaj kontrate mund të angazhojë me detyra të caktuara persona të tjerë ndihmës. Në çdo rast përgjegjësia për plotësimin e detyrimeve të parashikuara nga kjo kontratë i mbetet ofertuesit të shërbimit dhe nuk kalon tek të tretët.

**Neni 9**  
**KONFIDENCIALITETI**



OFRUESI I SHËRBIMIT gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate nuk duhet të bëjë publike asnjë informacion konfidencial, që ka të bëjë me veprimtarinë e firmes.

**Neni 10**  
**ZGJIDHJA E KONTRATËS**

10.1 Nëse kontrata zgjidhet në mënyrë të njëanshme përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në të, pala zgjidhëse duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër 20 (njëzetë) ditë përpara. Në të kundërt pala zgjidhëse i paguan palës tjetër një dëmshpërblim në masën e dyfishit të çmimit të caktuar në nenin 3 (tre) të kësaj kontrate.

10.2 Kur njëra nga palët e kësaj kontrate, nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër e kësaj kontrate, sipas rastit mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës, sipas nenit 698 të Kodit Civil.

**NENI 11**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**



Për çdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lindë në të ardhmen ndërmjet tyre, palët e diskutojnë dhe mundohen t'i zgjidhin ato me mirëkuptim. Në të kundërt i drejtohen Gjykatës.

**NENI 12**  
**DISPOZITA TË FUNDIT DHE PËRMBYLLËSE**

12.1 Për çka nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohet legjislacioni Shqiptar në fuqi.

12.2 Komunikimi midis palëve do të jetë i vlefshëm në çdo rast.

12.3 Të gjitha shtesat dhe ndryshimet që mund të bëhen kësaj kontrate janë të vlefshme dhe bëhen pjesë e kësaj kontrate vetëm nëse bëhen me shkrim dhe firmosur rregullisht nga palët apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar.

Kontrata përpilohet në katër kopje, me të njëjtën fuqi ligjore, dhe pasi u gjend e rregullt nënshkruhet nga të dy palët pa vërejtje.

**PËR Firmën ANSI2016 shpk**  
**Arber HOXHA**

Arber Hoxha

**OFRUESI I SHËRBIMIT**  
**Jetmira ZENELI**

Jetmira Zeneli  
**JETMIRA ZENELI**  
**KONTABILI S.E**  
**LIC 856/2015**

Jetmira Zeneli